



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 2939/prot.  
1

Tiranë, më 03.05.2024

**UDHËZIM**

Nr. 9, datë 03.05.2024

**PËR ORGANIZIMIN E TESTIMIT TË INFORMATIZUAR TË KANDIDATËVE  
PËR T'U PUNËSUAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

**KREU I  
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Organizimi i testimit të informatizuar**

Organizimi i testimit të informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar zhvillohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përshkruara në këtë udhëzim.

**Neni 2**

**Qendra e testimit dhe afatet e zhvillimit të testimit të informatizuar**

Testimi i informatizuar i kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar zhvillohet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

**Neni 3**

**Drejtimi, administrimi dhe monitorimi i testimit të informatizuar**

QSHA drejton, administron dhe monitoron procesin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar si dhe bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP) për mbarëvajtjen e zhvillimit të procesit të testimit të informatizuar.

#### **Neni 4**

#### **E drejta e pjesëmarrjes në testimin e informatizuar**

Në testimin e informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar kanë të drejtë të marrin pjesë:

- a) kandidatët që kanë zgjedhur që në të njëjtën ditë me provimin e licencimit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit dhe e kanë kaluar me sukses këtë provim, të kryejnë edhe testimin e informatizuar për të konkurruar për pjesëmarrje në portalin “Mësues për Shqipërinë”.
- b) kandidatët që zgjedhin të kryejnë vetëm testimin e informatizuar, për pjesëmarrje në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

#### **Neni 5**

#### **Vlerat udhëheqëse dhe parimet e procesit**

Procesi i testimit të informatizuar udhëhiqet nga vlerat e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, transparencës, objektivitetit dhe meritës së kandidatëve, duke respektuar parimet e mëposhtme:

- a) Ruajta e fshehtësisë së fondit të pyetjeve;
- b) korrektësia e kandidatëve në mjedisin e testimit;
- c) korrektësia e administrimit;
- ç) vlerësimi i standardizuar.

### **KREU II**

### **DETYRAT DHE KOMPETENCAT E INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE**

#### **Neni 6**

#### **Detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) kryen detyrat e mëposhtme:

- a) harton dhe publikon në faqen zyrtare të saj programet orientuese të testimit të informatizuar sipas profileve përkatëse, të cilat përmbajnë njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë kandidati si dhe referencat e literaturës;
- b) cakton hartuesit e fondit të pyetjeve me alternativa, që do të përdoret për çdo testim sipas

- profilin përkatës;
- c) merr në dorëzim zyrtarisht me procesverbal nga hartuesit e fondit të pyetjeve, fondin e pyetjeve me alternativa të çdo profili, për të cilin do të zhvillohet testimi;
  - ç) organizon fondin e pyetjeve nëpërmjet koordinatorit të profilin lëndor përkatës, i cili vlerëson dhe miraton saktësimin e përmbajtjes së fondit të pyetjeve sipas kritereve të përcaktuara nga QSHA-ja;
  - d) dorëzon zyrtarisht me procesverbal në QSHA fondin përfundimtar të pyetjeve me alternativa të miratuar për çdo profil lëndor, në format elektronik;
- dh) përcakton dhe publikon në faqen zyrtare të institucionit informacionin për strukturën përmbajtësore të testit;
- e) dorëzon zyrtarisht në QSHA strukturën e testit për çdo profil testimi për të dyja kategoritë e përcaktuara në nenin 4, të këtij udhëzimi.

## **Neni 7**

### **Detyrat dhe kompetencat e Qendrës së Shërbimeve Arsimore**

1. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) është përgjegjëse për zhvillimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar. QSHA-ja zbaton procedurat për zhvillimin e testimit të informatizuar përmes teknologjisë digjitale.
2. QSHA-ja, lidhur me zhvillimin e testimit të informatizuar, kryen detyrat e mëposhtme:
  - a) merr në dorëzim fondin e pyetjeve për çdo profil lëndor të miratuar nga ASCAP;
  - b) merr në dorëzim strukturat e testit për çdo profil lëndor që do të zhvillohet për kandidatët për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, të cilët kanë përmbushur detyrimin e pajisjes me licencë;
  - c) merr në dorëzim strukturat e testit për çdo profil lëndor që do të zhvillohet për kandidatët për t'u punësuar në institucionet arsimore parauniversitare, të cilët në të njëjtën ditë me zhvillimin e testimit të informatizuar të portalit japin edhe provimin e licencës për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit;
  - ç) digjitalizon fondin e pyetjeve për çdo profil lëndor të informatizuar;
  - d) harton kalendarin e testimit të informatizuar sipas profileve lëndore të përcaktuara në këtë udhëzim, pas marrjes në dorëzim të listave të kandidatëve nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP). Lista e kandidatëve që do t'i nënshtrohen testimit të informatizuar dërgohet 1 (një) javë para fillimit të sesionit të zhvillimit të testimit të informatizuar dhe përmban këto të dhëna: emër, atësi, mbiemër, ID, profili, zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP-të) ku dëshiron të konkurrojë kandidati;
  - dh) publikon listat e kandidatëve sipas profilin, datës dhe orarit të caktuar për zhvillimin e testimit në portalin "Mësues për Shqipërinë";
  - e) verifikon identitetin përmes dokumenteve përkatëse të kandidatëve (pasaportë biometrike/kartë identiteti) pjesëmarrës në testimin e informatizuar;

- ë) siguron kushte të përshtatshme në sallat e përcaktuara për zhvillimin e testimit të informatizuar përmes teknologjisë digjitale;
- f) siguron kushte të përshtatshme për kandidatët me aftësi të kufizuara;
- g) merr masa për gjenerimin e tezës sipas strukturës së testimit të informatizuar të miratuar nga ASCAP;
- gj) mban procesverbale për çdo vendimmarrje gjatë procedurave të zhvillimit të testimit të informatizuar, deri në shpalljen e rezultateve;
- h) dërgon në AKAP dhe në MAS rezultatet e testimit përfundimtar.
- i) harton raportin statistikor lidhur me rezultatet e testimit të informatizuar dhe i'a paraqet ministrit përgjegjës për arsimin;
- j) në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) shqyrton ankimimet për testimin e informatizuar të kandidatëve të cilët kanë të drejtën e ankimimit brenda tri (3) ditëve nga shpallja e rezultatit.

## **Neni 8**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar**

AKAP nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) kryen detyrat e mëposhtme:

- a) përgatit listën e kandidatëve të parashikuar në shkronjën “b” të nenit 4, të këtij udhëzimi, të cilët do të marrin pjesë në testimin e informatizuar dhe e dërgon në QSHA;
- b) bashkëpunon dhe mbështet QSHA për mbarëvajtjen e testimit të informatizuar.

## **Neni 9**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e kandidatëve gjatë testimit të informatizuar**

1. Ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar, kandidatët duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhtme:
  - a) Të jenë të pajisur me dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë biometrike);
  - b) të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;
  - c) të mos mbajnë dhe të mos përdorin celularë dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter përjashtimi;
  - ç) të mos pinë duhan dhe të mos konsumojnë ushqime në mjediset e testimit;
  - d) të mos komunikojnë me njëri-tjetrin gjatë zhvillimit të testimit.
  - dh) të jenë të pajisur me formularin e pjesëmarrjes në testimin e informatizuar, i cili lëshohet nga komisioni i vlerësimit të dosjeve të DRAP-së.
2. Nëse një kandidat nuk paraqitet në testim ose tërhiqet përpara fillimit të tij, atëherë testimi nuk vlerësohet si i kryer.
3. Tërheqja nga testimi i informatizuar nuk mund të kryhet pas hyrjes në sallën e testimit.

4. Kandidati që del nga salla e testimit, nuk do të rihyjë në sallë gjatë zhvillimit të testimit.

### **Neni 10**

#### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

1. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nëpërmjet dy fazave:
  - a) faza e parë: vlerësimi me pikë nga dokumentet e dosjes së kandidatit (në masën 30 pikë).
  - b) faza e dytë: vlerësimi nga testimi i informatizuar (në masën 70 pikë).
2. Teza e testimit të informatizuar për kandidatët e parashikuar në shkronjën “b”, të nenit 4, të këtij udhëzimi, përmban 50 pyetje, përgjigjet e sakta të të cilave vlerësohen me 100 pikë. Pikët që kandidati fiton nga testimi i informatizuar konvertohen maksimalisht në 70 pikë, duke shumëzuar numrin e pikëve që kandidati ka marrë në testimin e informatizuar me 0.7.
3. Pikët e parashikuara për kandidatët e parashikuar në shkronjën “a”, të nenit 4, të cilët në të njëjtën ditë me provimin e licencës kanë zgjedhur të kryejnë edhe testimin e informatizuar vlerësohet si më poshtë:
  - a) Provimi i licencës 40 pikë (sasia e pikëve që kandidati fiton nga provimi i licencës shumëzohet me 0.4.).
  - b) Testimi i informatizuar për njohuritë psiko-pedagogjike 30 pikë.
4. QSHA-ja bën konvertimin e vlerësimit të testimit të informatizuar dhe ua dërgon AKAP-së dhe MAS.

### **KREU III**

#### **ORGANIZIMI I TESTIMIT TË INFORMATIZUAR**

### **Neni 11**

#### **Programet orientuese**

1. Programet orientuese për testimin e informatizuar hartohen dhe publikohen nga ASCAP për të dy kategoritë e parashikuar në nenin 4 të këtij udhëzimi. Hartimi i tyre bëhet mbi bazën e kurrikulës së arsimit parauniversitar sipas profilit përkatës.
2. Programi orientues për arsimin parashkollor bazohet në të gjitha programet mësimore të arsimit parashkollor.
3. Programi orientues për arsimin fillor bazohet në të gjitha programet lëndore të arsimit fillor.
4. Programet orientuese për të gjitha profilet bazohen në programet lëndore përkatëse.
5. Programet orientuese për kandidatët e profileve artistike bazohen në programet mësimore për degët e muzikës, artit figurative dhe baletit.
6. Programet orientuese për kandidatët e arsimit special, përgatiten sipas programeve të formimit të përgjithshëm të përgatitur nga ASCAP.

## **Neni 12**

### **Llojet e testimit të informatizuar**

Provimi i testimit të informatizuar realizohet për profilet/lëndët e mëposhtme:

Arsimi parashkollor, arsimi fillor, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë frënge, Gjuhë italiane, Gjuhë gjermane, Matematikë, Fizikë, Biologji, Kimi, Histori, Gjeografi, Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK), Shkenca sociale, Ekonomi, Edukim fizik, Muzikë, Art pamor, Arsim special, muzikë për shkollat artistike, art pamor për shkollat artistike, balet.

## **Neni 13**

### **Hartimi i fondit të pyetjeve**

1. ASCAP ngre grupe pune për hartimin e fondit të pyetjeve për zhvillimin e testimit të informatizuar për kandidatët për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, sipas profileve të testimit të informatizuar me përfaqësues mësues dhe specialistë të sistemit të arsimit parauniversitar.
2. Fondi i pyetjeve hartohet në bazë të standardeve të përcaktuara nga QSHA-ja dhe pyetjet grupohen si më poshtë:
  - a) Në pjesë/module sipas grupimeve kryesore të profileve.
  - b) Nivele vështirësie: Niveli 1: i lehtë, Niveli 2: mesatar dhe Niveli 3: i vështirë, duke u konvertuar respektivisht në 1 pikë, 2 pikë dhe 3 pikë të tezës.
3. Hartuesit kanë përgjegjësi për saktësinë e pyetjeve të hartuara nga ana e tyre dhe për zbatimin e ligjit nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", të ndryshuar.
4. Grupet e hartuesve dorëzojnë fondin e pyetjeve për testimin e informatizuar në ASCAP, i cili miraton fondin e pyetjeve dhe raportin e disiplinave sipas programeve orientuese.

## **Neni 14**

### **Miratimi i fondit të pyetjeve të testimit të informatizuar**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në lidhje me fondin e pyetjeve për çdo profil, ndjek procedurat e mëposhtme:

- a) merr në dorëzim me procesverbal nga hartuesit fondet e pyetjeve të testimit të informatizuar dhe i miraton ato;
- b) shqyrton fondin e pyetjeve me synimin për përfaqësimin sa më të mirë të njohurive të programit, duke konsideruar:
  - i) peshën e secilës pjesë të programit që do të përfaqësohet në test dhe përputhshmërinë e pyetjeve me programin orientues të shpallur, si dhe formulimin e saktë të tyre nga ana e përmbajtjes. Kur konstatohet se nuk përmbushen këto kushte, ndryshon formulimin e pyetjes, duke e bërë atë të vlefshme për fondin e pyetjeve ose e heq atë;

- ii) përcaktimin e vështirësisë së pyetjeve duke bërë ndryshime, nëse e sheh të arsyeshme;
  - iii) përgjigjet për saktësinë e fondit të pyetjeve dhe përgjigjeve respektive të çdo profili.
- c) përcakton raportin në përqindje të përfshirjes së pyetjeve të ndara sipas nivelit të vështirësisë në përputhje me karakteristikat e programit të informatizuar të QSHA-së;
- ç) i dorëzon QSHA-së fondin e miratuar të pyetjeve me alternativat përkatëse ku saktësohet përgjigjja e saktë.

## **Neni 15**

### **Mbarëvajtja e zhvillimit të testimit të informatizuar**

1. Testimi i informatizuar zhvillohet sipas kalendarit të hartuar nga QSHA-ja, në bazë të mundësisë së sigurimit të ambienteve të testimit.
2. Sallat ku do të zhvillohet testimi, mbikëqyren nga një ose më shumë administratorë të caktuar nga QSHA. Administratorët mbikëqyrës janë përgjegjës për mbarëvajtjen e testimit sipas përcaktimit në këtë udhëzim.
3. Në ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar duhet të jenë të pranishëm 1–2 përfaqësues nga ASCAP, të cilat asistojnë në prodhimin elektronik të tezës së testimit të informatizuar dhe mbajnë procesverbal për saktësinë e procedurës së ndjekur dhe pyetjeve të përzgjedhura nga sistemi.
4. Përfaqësuesit e ASCAP ndjekin procedurat e zhvillimit e testimit të informatizuar në QSHA deri në përfundimin e testimit dhe nënshkruajnë procesverbalin me rezultatet e testimit, përmes videomonitorëve.

## **Neni 16**

### **Modalitetet e zhvillimit të testimit të informatizuar**

1. Për çdo seancë testimi, pyetjet e përzgjedhura nga sistemi në mënyrë automatike janë të njëjta për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në testimin e informatizuar.
2. Testimi i informatizuar për kandidatët e përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 4, të këtij udhëzimi zgjat 30 minuta dhe përmban 20 pyetje të cilat maksimalisht vlerësohen me 30 pikë, ndërsa testimi i informatizuar për kandidatët e përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 4, zgjat 60 minuta dhe përmban 50 pyetje, të cilat maksimalisht vlerësohen me 70 pikë.
3. Provimet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni zhvillohen vetëm me një raund. Ato fillojnë dhe mbarojnë njëkohësisht për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në testim, në ditën dhe orarin e caktuar.
4. Vlerësimi i kandidatëve kryhet në mënyrë automatike nga sistemi kompjuterik në çastin e përfundimit të testimit. Rezultati përfundimtar i shfaqet kandidatit në monitor dhe printohet në mënyrë automatike nga sistemi së bashku me përgjigjet e dhëna. Çdo kandidat nënshkruan fletën me rezultatet e testimit të printuar në përfundim të testimit përkatës.
5. QSHA-ja ka të drejtë që, në rast se evidenton shkelje të rënda të rregullave të provimit, t'u

propozojë përfaqësuesve të ASCAP përjashtimin e kandidatit që thyen rregullat. QSHA-ja mban procesverbal, ku evidenton shkeljet e konstatuara.

6. Nëse konstatohet se testimi nuk është zhvilluar sipas rregullave, testimi për kandidatët e asaj salle do të vlerësohet si jo i kryer. Vendimi në këtë rast është në kompetencë të QSHA-së dhe të përfaqësuesve të ASCAP.

#### **Neni 17**

#### **Konflikti i interesit**

1. Hartuesit e fondit të pyetjeve nuk duhet të jenë autorë të teksteve dhe të librave ndihmës për nxënësit (përveç atyre që botohen nga institucionet e varësisë të MAS).
2. Hartuesit e fondit të pyetjeve dhe personat e autorizuar nga ASCAP nuk duhet të kenë lidhje familjare me kandidatët (bashkëshort /bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit /bashkëshortes).
3. Hartuesit e fondit të pyetjeve dhe personat e autorizuar nga ASCAP, nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit në institucionet përkatëse.

### **KREU IV**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **Neni 18**

#### **Ruajtja e dokumentacionit**

Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim ruhet në institucionet përkatëse në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### **Neni 19**

#### **Mbulimi i shpenzimeve**

Shpenzimet për realizimin e testimit të kandidatëve që aplikojnë për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar përballohen nga buxheti i institucioneve respektive që përfshihen në këtë proces, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### **Neni 20**

#### **Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr. 12, datë 27.02.2018, i Ministrisë të Arsimit, Sportit



dhe Rinisë “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

**Neni 21**  
**Zbatimi i udhëzimit**

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSMINISTRI**

**NINA GUGA**

